

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E ENJTE 3 SHKURT 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Para dy ditësh po ndiqja një konikë televizive, ku disa zonja, punonjëse të një biznesi fason, protestonin për kushte minimale të punës. Çfarë kërkonin ato?! Ato kërkonin që pronari i kompanisë t'i paguante për orët shtesë dhe për punën gjatë fundjavës, të shtunë dhe të diel. Për një vend demokratik dhe Perëndimor, ku Shqipëria dëshiron të bashkohet, kërkesat e këtyre zonjave do të dukeshin absurde. Pse?! Sepse këto janë të sanksionuara në ligj, në Kodin e Punës dhe në Kushtetutë, por që në vendin tonë, të varfëruar, të vjedhur dhe të keqeverisur nga këta që janë ulur pas meje, të punësuarit thjesht duhet të kërkojnë të drejtat e tyre minimale dhe nuk mund të kërkojnë më tepër. Jam e sigurt që edhe këto kërkesa minimale vështirë se mund t'u plotësohen, edhe pse përcaktohen qartë në legjislacion. Këto gra dhe vajza, ashtu si shumë të tjera para tyre, do të detyrohen të mbyllin gojën, do të kthehen kokulur në vendet e punës, sepse në të kundërt mund të largohen dhe të humbasin pagën, me të cilën mbajnë familjet. Kërcënimi me vendin e punës është forma më e përhapur e diskriminimit për të punësuarit shqiptarë. Pse?! Sepse në Shqipëri shteti nuk funksionon, nuk mbron qytetarin, nuk mbron punonjësin, por e sheh atë si armik. Shihni dhunën, diskriminimin, përçmimin dhe injorimin e shtetit ndaj qytetarëve të "5 Majit", të Laprakës dhe të Paskuqanit, të cilët kërkojnë zbatimin e legjislacionit aktual dhe të konventave ndërkombëtare. Edi Rama i sheh ata si armiq sa herë që i pengojnë aferat e mëdha korruptive.

Shteti nuk mbron të drejtat kushtetuese të qytetarëve, por i shkel ata në mënyrë të përditshme, shteti bëhet palë me oligarkët dhe i bie punonjësit e qytetarit. Të dashur deputetë, Nuk e di nëse mbledhja e radhës së komisionit ishte për të qeshur apo për të qarë. Dy ministritë përgjegjëse për implementimin e kësaj konvente as nuk ishin ulur, as nuk kishin komunikuar dhe as nuk kishin rakorduar asnjë raport paraprak para se të vinin në komision. Ata nuk kishin asnjë plan pune, asnjë paketë me akte ligjore apo nënligjore, as buxhet të parashikuar dhe vulën e vuri zëvendësministrja, e cila tha se nuk kishte pasur asnjë rast të raportuar dhune apo ngacmimi nga institucionet përkatëse gjatë një viti, ndërkohë që të gjitha raportet ngrenë alarmin për dhunën dhe ngacmimin në vendet e punës. Pra, qeveria qartazi po sjell edhe një herë një konventë sa për të thënë, sa për të larë gojën, por nuk ka ndërmarrë asnjë hap për implementimin e saj dhe asnjë hap për të siguruar një mjedis më të sigurt për punonjësit.

Pra, ky është një tjetër akt i mirëfilltë propagande. Probleme nuk ka vetëm në sektorin privat, sepse dhunë, diskriminim, ngacmime, kërcënime dhe shantazhe ndodhin në mënyrë të përditshme edhe në sektorin publik. Kemi mijëra raste të shkarkimit e të hedhjes në rrugë të punonjësve të administratës vetëm për motive politike, ku sot paguhen dy rroga për një vend pune, duke i sjellë një dëm të konsiderueshëm buxhetit të shtetit. Ka qindra vendime gjykate që nuk implementohen, sepse ministri apo deputeti i maxhorancës do të mbajë militantin apo patronazhistin në atë vend pune. Sot

administrata publike është nën terrorin e shefit, drejtorit, zëvendësministrit, ministrit e me radhë nga e gjithë hierarkia shtetërore. Administrata publike detyrohet të kryejë detyrat shtetërore, por në fushata elektorale duhet të angazhohet edhe si patronazhiste për të siguruar vota për partinë- shtet dhe në rast se kundërshton, do të shtojë radhën e të papunëve në Shqipëri, papunësi që ka kapur shifra alarmante, sidomos gjatë periudhës së pandemisë. Për ta bërë më të qartë: a e dini sa punonjës të administratës kanë bërë patronazhistin gjatë fushatës zgjedhore të 25 prillit në njësitë administrative 9 dhe 11? Për ministren Manastirliu kanë punuar rreth 700 patronazhistë në total, për të cilët 355 ka informacion, nga këta 250 janë nëpunës civilë, të cilët kanë patronazhuar 25445 qytetarë, votues. Për zotin Manja kanë punuar 530 patronazhistë, rreth 180 nëpunës civilë, të cilët kanë patronazhuar 18480 qytetarë. Ja pra, kjo është dhuna dhe diskriminimi që ushtrohet ndaj punonjësve civilë të administratës. Për këtë kam çuar kallëzim në SPAK, por ai hesht për krimin më të madh zgjedhor, që dhunoi të drejtën kushtetuese për të votuar të lirë. Për fat të keq, presioni mbi rrogën e ka shndërruar armatën e të punësuarve në një trupë pa forcë reagimi dhe, për më tepër, pa një vizion dhe orientim për të kërkuar të drejtat e tyre.

Një anketë e zhvilluar së fundi nga Aleanca Gjimore për Zhvillim dhe IDM-ja, financuar nga Bashkimi Europian dhe ambasada suedeze, zbuloi se vetëm një pjesë e vogël e të punësuarve, sidomos ata në sektorin privat, ishin të informuar se e kishin të drejtën e një ankese për rastet e diskriminimit në vendet e punës, por nuk dinin se cila ishte struktura që duhet ta trajtonte shqetësimin e tyre. Kjo situatë dëshmon, më së paku, se autoritetet shtetërore qëndrojnë shumë larg shqetësimeve të punonjësve dhe nuk kanë ndjekur programe informuese dhe orientuese. Ajo që rezultoi më shqetësuese, ndër të gjitha të dhënat, në anketën e zhvilluar së fundi, është qasja e individëve ndaj diskriminimit në vendin e punës. 100% e burrave dhe 97% e grave as nuk e çonin ndër mend të ankoheshin për rastet e diskriminimit në punë, sepse ishin të sigurt që jo vetëm mund të mos merrnin zgjidhjen e rastit të tyre, por mund të iknin nga vendi i punës. Shumë prej tyre përjetojnë diskriminimin që shfaqet në forma të ndryshme, duke filluar nga largimi, transferimi në vendet e punës në formë ndëshkimi, moslejimi i kontratave kolektive apo pengimi për krijimin e grupeve të organizuara dhe sindikatave. Mungesën e sindikatave, e cila është një minus shumë i madh për shoqëritë e ndryshme dhe ato shqiptare, Kryeministri Rama e konsideron si vlerë. Në takime me investitorë të huaj ai i josh ata, duke u shprehur se në Shqipëri nuk ka sindikata, ndaj hajdeni hapni kompanitë tuaja në dëm të punonjësve shqiptarë. Është e qartë se situata e vështirë me punësimin dhe mungesa e strategjive në Shqipëri nuk vjen nga padija dhe as nga injoranca, por është një orientim qeveritar për të mbajtur qytetarët në zgjedhën e bukës, për t'i nëpërkëmbur, për t'ua hequr shqisën e reagimit dhe, në fund, për t'ua marrë votën me një thes miell e me kërcënimin apo joshjen për vendin e punës. Shqipëria jeton në një vend autokratik, ku qytetarët, sidomos ata të punësuarit, duhet të pranojnë diktatin dhe diskriminimin.

Zonja dhe zotërinj deputetë, Aktualiteti në të cilin po ratifikojmë këtë konventë "Për dhunën dhe ngacmimin në punë" të Organizatës Ndërkombëtare të Punës është më i pafavorshmi që ka pasur ndonjëherë për gratë dhe vajzat shqiptare këta 32 vjet tranzicion demokratik. Dhuna fizike, e cila shpesh çon në humbjen tragjike të jetës së nënave dhe të vajzave, është rrezik i shpeshtë. 106 gra kanë humbur jetën këto vitet e fundit, sepse sistemi i referimit të mbrojtjes së grave nga dhuna ka rënë dhe nuk funksionon. Në vitin 2018, 11 gra kanë humbur jetën dhe ka mbi 4000 që kanë marrë urdhra mbrojtjeje; në vitin 2019, 12 gra kanë humbur jetën dhe 3200 kanë marrë urdhra mbrojtjeje; në vitin 2020, vetëm në dy muajt e parë, 5 gra kanë humbur jetën dhe mijëra e mijëra të tjera kanë marrë urdhra mbrojtjeje. Periudha e pandemisë shënoi një kapitull të errët në sigurinë e jetës së gruas në Shqipëri, pra ka mijëra raste dhune më shumë, por shteti hesht, maxhoranca, deputetët, heshtin, pseudoopozita hesht e hesht. Është vetë shteti që nxit dhunë dhe konflikte të vazhdueshme sociale, si dhe mbështet dhunën ndaj grave, sepse kur papunësia është ulur këmbëkryq, varfëria thellohet

gjithnjë e më shumë. Taksat dhe çmimet shtrenjtohen në mënyrë të palogjikshme dhe e gjithë kjo sjell frustrim, krijon premisë për konflikte dhe përplasje në familje, në raporte shoqërore, që shpesh përfundojnë në akte dhune. Të nderuar kolegë, Vetëm një mjedis i lirë, me konkurrencë të ndershme, me mundësi të barabarta për të gjithë garanton të drejtat e punonjësve, garanton të drejtat e grave, dinjitetin e gruas dhe mbrojtjen e saj nga çdo abuzim. Në çdo vend, në familje, në organizata, në biznese, në parti politike, ku gratë shihen si shërbëtore, si fasadë, si vegla për qëllimet e burrave, ato janë vende ku gratë dhunohen. Gratë që detyrohen të përdoren për të mbijetuar, për të siguruar atë që u takon apo për të bërë karrierë janë fatkeqe, por më të mjera dhe pa të ardhme janë ato familje, organizata, shoqëri që nuk u ofrojnë shumë grave. Akoma më imorale se çdo gjë është përdorimi i grave kundër grave, veçanërisht në politikë. Fundi i çdo morali, i çdo standardi minimal civil i një organizate, sidomos partie politike, është pikërisht kur përdor gratë kundër grave. Ata që përdorin gratë kundër grave janë moralisht mjeranë dhe politikisht të dështuar. Ndaj sot dua t'u bëj thirrje të gjitha grave të mos bëhen pre, viktimë apo vegla të politikës të së keqes, të politikës që nuk pranon lirinë, konkurrencën e ndershme, mundësitë e barabarta dhe, mbi të gjitha, dinjitetin personal. Faleminderit!